

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale, nëpërmjet akordimit të një huaje në shumën 50 milionë USD.

Qëllimi kryesor i projektit është përmirësimi i aksesit drejt qendrave të përzgjedhura agrobujqësore dhe të turizmit, si dhe forcimi i kapaciteteve të bashkive të këtyre qendrave në menaxhimin e aseteve rrugore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji nuk është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nevoja për akordimin e këtij financimi lind referuar problematikave infrastrukturore dhe nevojës për përmirësim në rrugët lidhëse rajonale, potencialit turistik që kanë zonat e projektit, si dhe vlerësimit të prioriteteve të qeverisë shqiptare me fokus zhvillimin e infrastrukturës.

Efektet e pritshme që ky projekt pritet të sjellë janë, si më poshtë:

1. Rehabilitimi i rrugëve rajonale dhe lokale, duke ofruar një lidhje më të mirë dhe më të sigurt me rajonet e përfshira ku jetojnë e punojnë rreth 80 000 (tetëdhjetë mijë) banorë.

2. Përmirësimi i klimës së qëndrueshmërisë në rrjetin rrugor, çka do të ndihmojë në përfitimin e një aftësie të qëndrueshme dhe të dëshiruar në sigurimin e shërbimeve të transportit.
3. Forcimi i kapaciteteve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe bashkive të këtyre rajoneve për të menaxhuar projektet e ndërtimit të aseteve rrugore, në drejtim të një prioritizimi më të mirë të investimeve dhe aktiviteteve të mirëmbajtjes.

Në përputhje me objektivat e tij, zbatimi i projektit është i ndarë në tri pjesë, si më poshtë vijon:

Pjesa 1. Përmirësimi i aksesueshmërisë.

Këtu përfshihen:

- a) punimet për rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe rurale në bashkitë e përzgjedhura;
- b) iniciativat e lidhura me sigurinë rrugore, përfshirë gjurmët e këmbësorëve, korsitë e dedikuara për biçikletat, përmirësimet e sigurisë, shenjat e orientimit dhe marrja në konsideratë e pjesëve estetike ku rrugët i shërbejnë zonave turistike ose kalojnë nëpër zonat urbane.

Pjesa 2. Ngritja e kapaciteteve për bashkitë.

Këtu përfshihen:

- a) ngritja e kapaciteteve të bashkive për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetet rrugore, ofrimi i këshillave për të përmirësuar sistemet ekzistuese të menaxhimit të aseteve për të përmirësuar planifikimin dhe prioritizimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes dhe rehabilitimit, zhvillimi i një marrëveshjeje standarde të nivelit të shërbimit për të përmirësuar efikasitetin e ekzekutimit të mirëmbajtjes, sigurimi i këshillave për të zhvilluar një kuadër për financimin e qëndrueshëm të mirëmbajtjes dhe kryerjen e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për komunat e përzgjedhura për të zbatuar në mënyrë efektive programet e mirëmbajtjes së rrugëve;
- b) mbështetja e bashkive të përzgjedhura për implementimin e programeve të zhvillimit rural, përfshirë dhënien e këshillave për vlerësimin e potencialit të tregut në nivel fshati për të përcaktuar se cilat aktivitete prodhuese japin kthimin më të lartë, përgatitjen e propozimeve për investime për të përdorur fondet e grantit të disponueshme në programin “100 fshatrat” ose në programet e tjera të zhvillimit rural për të adresuar kërkesat e tregut dhe zbatimin e aktiviteteve të lartpërmendura.

Pjesa 3. Mbështetja e menaxhimit të implementimit.

Kjo pjesë parashikon dhënien e mbështetjes për menaxhimin e projektit ku përfshihen mes të tjerave zhvillimi dhe mbajtja e një sistemi të informacionit gjeografik (GIS), përdorimi i një databaze për prioritizimin e rrugëve rajonale dhe rurale.

Afati i fundit për tërheqjen e fondeve në kuadër të kësaj marrëveshjeje huaje është data 31 dhjetor 2022.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Hartimi i projektligjit bazohet në nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, si dhe në nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja e huas është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.172, datë 28.3.2018, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në përputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshja do t’i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale, nëpërmjet akordimit të një huaje në shumën 50 milionë USD.

Marrëveshja e huas i bashkëlidhet projektaktit dhe përmban 6 nene, 3 skedule dhe 1 shtojcë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Huaja që akordohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ka termat financiarë të mëposhtëm:

Shuma	50 000 000 USD;
Interesi:	bazuar në normën e referencës + marzh të pandryshueshëm;
Tarifa <i>Front-end</i> :	0.25% e shumës së huas;
Komision angazhimi:	0.25% që përlogaritet mbi vlerën e padisbursuar të huas;
Maturimi:	29.5 vjet duke përfshirë periudhën prej 6 vitesh pa pagesë principali.

Projekti është pjesë e parashikimeve të programit buxhetor afatmesëm 2018 – 2020 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

KËSHILLI I MINISTRAVE